



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 167, datë 29.09.2022

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 37,
DATË 28.05.2015 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR
PËRZGJEDHJEN E SHOQËRISË AUDITUESE PËR SHOQËRINË E SIGURIMIT”, E
NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE

Në rregulloren nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, e ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 4 bëhet ndryshimi si më poshtë:

1) Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, kriteret e përcaktuara në pikën 1, shkronja “a” dhe “b” dhe pikën 2, shkronja “a” të këtij neni, duhet të plotësohen bashkërisht nga të dyja shoqëritë audituese, ndërkohë kriteret e tjera të këtij neni plotësohen nga secila prej shoqërive audituese.”.

2. Në nenin 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1) Shkronja “a”, e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Vendimin e asamblesë së aksionarëve të shoqërisë administruese për emërimin e shoqërisë audituese apo emërimin e shoqërive audituese kur auditimi do të kryhet në mënyrë të përbashkët nga dy shoqëri audituese;”.

2) Shkronja “d” e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“d. Vërtetim nga Organizata profesionale e audituesve ligjorë/Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, që vërteton se:

- i. shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, është person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë; dhe
- ii. Shoqëria audituese ose të paktën njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese ka jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);”.

3) Shkronja “d/1” e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“d/1. Vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), që vërteton se “ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese/shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët, me titull profesional “auditues ligjor” kanë jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);”.

4) Shkronja “f” e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“f. Vërtetim nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në nenin 4, pika 1, shkronja “f” të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;”.

5) Shkronja “g” e pikës 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“g. Deklaratë për përmbushjen e kërkesës së parashikuar në nenin 4, pika 1, shkronja “f” dhe pika 2, shkronja “b” të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;

6) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Në rastin e auditimit të përbashkët nga 2 shoqëri audituese, për dokumentat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duhet të depozitohet një dokument të përbashkët. Për dokumentat e parashikuara në shkronjat “f”, “g”, “h” dhe “i” të pikës 1, të këtij neni, të dorëzohen për secilën nga shoqëritë audituese në rast auditimi të përbashkët”.

3. Në nenin 7 bëhet ndryshimi si më poshtë:

1) Paragrafi i dytë ndryshon me këtë përmbajtje:

“Autoriteti ka të drejtë të refuzojë shoqërinë/shoqëritë audituese, nëse gjatë kontrollit të cilësisë së punës së tyre, shoqëria ose njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, në tre vitet e fundit, (në rastet kur është kryer një kontroll i tillë), është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën C.”.